



REPUBLIKA E SHQIPERISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 91, Datë 04.07.2017

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE
PER VITIN 2017 PËR OSHEE SH.A.

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, gërmat “a” dhe “e”; neni 75; nenit 110, pika 2 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin Nr. 62, datë 15.09.2009; si dhe nenit 14 dhe 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2017 të Shoqërisë “OSHEE” sh.a, të përgatitur nga Grupi i Punës;

Konstatoi,

- “Operatori i Shpërndarjes së Energjise Elektrike” sha, në shkresën me Nr.23480 Prot, date 14.10.2016, ka paraqitur pranë ERE-s, një studim lidhur me “Planin Ekonomiko Financiar për vitin 2017”.
- Grupi i punës i ngritur me urdhërin Nr. 62, datë 02.11.2016 të kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga kompania.
- Edhe mbas kërkesave të përsëritura të ERE-s, për plotësim dokumentacioni, është konstatuar paraqitje jo e plotë, konform kërkesave të Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike, sipas Neni 11 Pika 2, përkatësisht:
 - ✓ Raport lidhur me zbatimin e planit të vitit paraardhës
 - ✓ Relacion shpjegues për investimet e planifikuara
 - ✓ Paraqitje e kërkesave të Neni 10 (Planet e Investimeve për të Licensuarit në veprimtarinë e Shpërndarjes së Energjise Elektrike).
 - ✓ Investimet janë paraqitur kryesisht me nocionet e buxhetimit dhe janë përdorur pak nocione teknike.
 - ✓ Koha e paraqitjes e pa mjaftueshme për një analizë teknike.
 - ✓ Nevoja për saktësim të planit pas vendimit lidhur me tarifat 2017.

- ✓ Nevoja për saktësimin e dokumentacionit sipas procedurave.
- ✓ Nevoja për miratimin e një plani Investimesh të bëshëm (fisibile).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2017 për shoqërinë “OSHEE” sh.a.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin dhe personat e interesuar për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI